



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:050691

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06004853

KPPP.nr.321/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Sigkos” SH.A., me NUI:811292979, me seli Prishtinë, rruga “...”, kundër debitorit “F.T.” B.I., me emër tregtar N.T.SH. “Beni Reisen” me NUI: 810436172, me seli në Letenc-Podujevë, përfaqësuar nga pronari F.T., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.15/24 të datës 17.01.2024, të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit F.T.” B.I., me emër tregtar N.T.SH. “Beni Reisen”, i paraqitur kundër urdhrit përmbarimor P.nr.15/24 të datës 17.01.2024, të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi.
- II. MBETET NË FUQI urdhri përmbarimor P.nr.15/24 i datës 17.01.2024, i Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi.

A r s y e t i m

Përmbaruesit Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.15/24 të datës 17.01.2024, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbarimore - Marrëveshja mbi Pengun Nr.566/21 e datës 07.09.2021, Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20211014-153 i datës 14.10.2021, duke detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrit t’ia paguaj kreditorit shumën prej 3,100.00 €, me kamatë referente si pjesë e kamatës ligjore, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën

kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, në të kundërtën realizimi i përmbarimit të realizohet përmes sekuestrimit të kolateralit të cilin debitori e ka lënë peng.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se kërkesa është parashkruar konform nenit 360 të LMD-së. Tutje ka shtuar se debitori ka paraqitur padi ndaj Korporatës Energjetike të Kosovës, për shkëputjen e kontratës në mënyrë arbitrare. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi të aprovohet dhe urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka deklaruar se i kundërshton në tërësi të gjitha pretendimet e debitorit duke theksuar se kreditori në cilësinë e siguruesit, përmes polices numër ... me datë të lëshimit 06.05.2022, ka bërë sigurimin e ekzekutimit të tenderit për transportin e punëtorëve të KEK-ut, në emër të F.T. B.I., ku si rezultat i mos zbatimit të kontratës ka paguar shumë prej 3,100.00 €, andaj pas kësaj kreditori i ka lindur drejta e rimbursimit të garancionit. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”*

dhe sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet:“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se “Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”.

Në rastin konkret Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin përmbartues përkatësisht Marrëveshjen mbi Pengun Nr.566/21 e datës 07.09.2021, e regjistruar në zyrën për regjistrim të pengut sipas Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20211014-153 të datës 14.10.2021, e cila i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.7, nenit 27 të LPP-së dhe nenit nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, për tu paraqitur si dokument përmbartues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit, pasi që Marrëveshja mbi Pengun Nr.566/21 e datës 07.09.2021, është regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20211014-153 të datës 14.10.2021, si dhe e njëjta është paraqitur në origjinal.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se kërkesa e kreditorit është parashkruar në kuptim të nenit 360 par. 1 të LMD-së, dhe gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar meqenëse në rastin konkret aplikohen dispozitat e nenit 349 të LMD-së, me të cilën përcaktohet se: “1. Kur të ketë kaluar afati i parashkrimit, kreditori kërkesa e të cilit është e siguruar me peng ose me hipotekë, mund të paguhet vetëm nga sendi i ngarkuar, në qoftë se e mban në dorë apo në qoftë se e drejta e tij është regjistruar në regjistrat publikë” andaj gjykata vlerëson se nuk kemi parashkrim të kërkesave, për faktin se propozimi për përmbartim është paraqitur mbi bazën e Marrëveshjes mbi Pengun Nr.566/21 e datës 07.09.2021

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.321/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.